



**zgjidh
të vendit**

KATALOGU VJETOR I PRODUKTEVE
“MADE IN ALBANIA”



përkrah
prodhuesit
shqiptarë



• Rrënjët janë të rëndësishme •



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) shqiptare, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme duke hartuar, zhvilluar dhe koordinuar programe ose projekte për zhvillimin dhe rritjen e tyre.

Misioni i AIDA-s është të forcojë kapacitetet e biznesit shqiptar për të konkurruar jashtë vendit si dhe, të luajë një rol të rëndësishëm për ndërtimin e një imazhi të denjë për Shqipërinë me fokus fuqizimin e bizneseve vendase, rritjen e mundësive të kompanive për eksport dhe tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

AIDA, nëpërmjet Drejtorisë NVM & Projekte, në partneritet me autoritetet qendrore dhe lokale, komunitetet e bizneseve si dhe partnerët e brendshëm dhe të huaj punon për forcimin e kapaciteteve të biznesit shqiptar me synim, konkurrimin në tregjet e huaja dhe promovimin e markës së vendit dhe ndërmarrjeve shqiptare. Në përmbushje të misionit të saj, bazuar në ligjin nr. 10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, neni 7 “Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme” prezantimi i produkteve “Made in Albania” shihet si një domosdoshmëri në tregun vendas.

Që prej muajit korrik 2020, AIDA ka ndërmarrë një fushatë për promovimin e këtyre produkteve. Në bazë të interesit të lartë të shprehur nga vetë kompanitë, por edhe biznese të kontaktuar nga stafi i AIDA-s, është bërë identifikim i produkteve vendase për fushatën “Zgjidh të Vendit” dhe përshkrimi i tyre.

Në fokus kryesor të çdo përshkrimi, janë produktet “Made in Albania”, një historik i shkurtër i kompanisë, si edhe të dhëna të domosdoshme për kontakt si adresa fizike, numri i telefonit dhe posta elektronike.

Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera. Rrënjët janë të rëndësishme. Ky katalog vjetor është botimi i katërt për fushatën “Zgjidh të Vendit”.

Për periudhën gusht 2022-dhjetor 2022, nga numri total i produkteve të promovuar, 6 prej tyre prodhohen nga sipërmarrëse gra dhe 21 produkte prodhohen nga sipërmarrës burra. Ndërsa, për sa i takon sektorëve kryesorë të promovuar, kryeson sektori i agropërpunimit dhe sektori i prodhimit të pijeve.



**Punime artizanale
Nebije Qotaj**

Artizane Nebije Qotaj e vendosur në Zogaj, Shkodër, krijon punime me ngjyrat dhe motivet tradicionale. Ajo krijon punime artizanale si: qilima me material prej lesh deleje, rrugica, sixhade, shaje, çanta, etj. Nebija ka arritur të hapë një punishtë, ku janë të punësuar 15 gra, të cilat prodhojnë çdo produkt në mënyrë artizanale, me mënyrat e trashëguara brez pas brezi, duke iu pershtatur edhe kërkesës së klientëve.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: nesa.zogaj@gmail.com ose në
068 226 2678



Ina's Farm

Ina's Farm është një biznes i krijuar nga një vajzë 26 - vjeçare, që punën e saj e bën me shumë pasion. Në fermën e Inës, prodhohet qumësht që për mjeljen e të cilit përdoren sisteme teknologjike të automatizuara. Risia e Ina's Farm qëndron në tregtimin e qumështit me tankera, ku secili konsumator mbush shishen e vet. Qumështi dhe nënproduktet e tij tregtohen tashmë në dyqanet e Ina's Farm.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: 069 700 0069.



**Akulloret dhe
kasatat "Bllaca"**

Akulloret dhe kasatat "Bllaca", e kanë zanafillën që prej vitit 1930, në qytetin e Durrësit, të cilat prodhoheshin nga vëllezërit Bllaca, me origjinë nga Gjirokastra. Trashëgimtarë e familjes Bllaca prodhojnë edhe sot akulloret dhe kasatat "Bllaca", të cilat janë produkte artizanale, pa konservant, që shquhen për shijen e tyre të veçantë. Vëllezërit vazhdojnë të ruajnë shijen e tyre tradicionale, të cilat tregtohen tashmë brenda edhe jashtë vendit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: edit_25@live.com ose në 355 67
220 9746.



**Kantina e Verës
Librazhd**

Kantina e Verës Librazhd, një traditë që prej vitit 1960, e cila shquhet për prodhimin e verës cilësore të kuqe dhe të bardhë, si dhe prodhimin e rakisë së frutave të ndryshme. Kantina e Verës Librazhd ka sjellë risi në përgatitjen e rakisë me kombinime të mjaltit dhe shafanit. Kjo kantine ka marrë pjesë edhe në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, e cila është vlerësuar për verërat e saj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: veralibrazhd@gmail.com ose në
069 325 7155.



Kompania e shpendëve Driza

Kompania Driza është kompleksi i mishit Patos, me një eksperiencë disa vjeçare në rritjen dhe mbarëshkrimin e shpendëve të ndryshëm, për prodhimin e vezëve dhe therjen e tyre. Kompania Driza kujdeset për rritjen e shpendëve të shëndetshëm, me drithëra natyrale dhe brenda kushteve të sigurisë, për të servitur produkte me vlera ushqyese. Kompania Driza merr pjesë edhe në panairë ndërkombëtare, ku falë cilësisë ka lidhur kontrata për eksportimin e produkteve të saj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: drizaal@yahoo.it ose në 069 209 9661.



Kompania "DEKA"

Kompania "DEKA" është themeluar në vitin 1992, si një nga kompanitë më të mëdha të industrisë së lehtë dhe ushqimore në Shqipëri. DEKA njihet për prodhimin e detergjentëve të cilët i përshatën klimës, kultures së larjes dhe fortësisë e ujit të vendit tonë. Detergjentët Deka janë të përbërë nga elementë, që sigurojnë pastrim dhe higjienë maksimale. Produktet DEKA plotësojnë standartet ndërkombëtare dhe i përshatën kërkesës së konsumatorëve.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@deka.al ose në 04 509 027.



Fabrika e përpunimit të qumështit "AGI 11"

"AGI 11" sh.p.k, është një kompani e themeluar në vitin 2010, e specializuar në prodhimin e produkteve të qumështit, në Kuçovë, Berat. Në fabrikë prodhohen 15 lloje djathrash, me teknologji italiane dhe punetore të kualifikuar. Produktet "AGI 11" prodhohen me qumësht të cilësisë së lartë dhe të kontrolluar nëpërmjet analizave laboratorike. Produktet kanë një shtrirje të gjere në treg, falë vlerave ushqimore dhe shijes delikate.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@agi11.com ose në 069 409 3150.



Produkte Bulmeti Zall-Herr

Baxho A & S Zall-Herr, ka filluar aktivitetin që prej 13 vitesh, në përpunimin e produkteve të qumështit, duke sjellë në tavolinat shqiptare produkte të një cilësie të lartë dhe me shijen e tyre unike. Dashuria për produktet shqiptare bio, ka bërë që baxho A & S, të ketë tashmë mbi 35 të punësuar.

Baxho A & S do të vijojë prodhimin e produkteve të bulmeti bio, pa konservantë, duke siguruar cilësi maksimale.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 068 20 55 657.



Beba Cosmetic

Beba Cosmetic është një sipërmarrje e prodhimit të produkteve higjieno-kozmetike, e themeluar në vitin 1993, në qytetin e Durrësit. Kompania prodhon aktualisht 56 artikuj të ndryshëm bazuar në ekstrakte natyrore të bimëve mjekësore. Produktet e Beba Cosmetic prodhohen brenda standardeve të sigurisë dhe janë të testuara klinikisht. Kompania është certifikuar me certifikatë cilësie të nivelit ndërkombëtar për të sjellë një produkt cilësor për tregun shqiptar dhe më gjerë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@bebacosmetic.com ose në 069 20 57 207.



Pularia Tirana

Kompania "Pularia Tirana" ndodhet në qytetin e Tiranës dhe operon në fushën e rritjes së shpendëve të rracave të ndryshme për therjen dhe tregtimin e mishit të freskët. Pularia funksionon sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë UNI-ISO 9001 dhe me personel të trajnuar. Pularia Tirana operon vetëm në tregtimin e produkteve të freskëta dhe jo në gjendje të ngrirë, për të ruajtur kualitetin e tij. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në:

info@pulariatirana.com ose në 068 60 00 089.



Lëngu kurativ "Vital"

Lëngu kurativ "Vital", vjen në treg nga një përvjeje personale e vetë prodhuesit dhe inxhinierit Z. Nafis Saraçi, produkt i cili tashmë është bërë shumë i njohur në tregun shqiptar dhe atë evropian. Ky produkt është krijuar që të mundësojë normalizimin dhe stabilizimin e të gjitha parametrevë të gjakut, nëpërmjet rigjenerimit të funksionit të mëlcisë dhe veshkave. Lëngu "Vital" mund të përdoret nga të gjitha grupmoshat për rigjenerimin trupor dhe rritjen e cilësisë së jetës.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 069 28 38 333.



Kantina e verës "Pali Estate"

Kantina e verës "Pali Estate" është themeluar në vitin 2007, në Divjakë, Lushnjë. Kantina ka nisur prodhimin e verës, fillimisht të sheshit të zi, duke vijuar me prodhimin e Cabernet, Sauvignon, Merlot, Teroldego. Kantina e verës Pali ka një staf të kualifikuar dedikuar prodhimit të verërave të një cilësie të lartë. Aktualisht, Pali Estate nxjerr në treg katër lloje verërash, në paketimin 0,75ml.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@paliestate.al ose në 069 40 90 000.



AIDA përfaqësohet nga prodhuesit shqiptarë



Çajërat e ftohtë "NANA"

NANA – Bio Flores është një kompani e krijuar për prodhimin e çajërave të ftohtë nga bimët medicinale. "NANA" kompani përdor teknologji moderne, si dhe ka një staf të kualifikuar dhe përkushtuar. Bimët medicinale që përdoren si lëndë e parë grumbullohen në malet dhe pyjet e Shqipërisë, ku natyra e egër dhe e pastër, ndërthuren me njëra-tjetrën për të dhënë një shije unike dhe sa më origjinale të çajit të ftohtë "NANA".

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@bioflores.al ose në 067 74 12 000.



AIDA përfaqësohet nga prodhuesit shqiptarë



Vera 'Alpeta'

E rrethuar me kodrina poshtë malit Tomorr shtrihet fshati Roshnik, i rrethuar me vreshta, të cilat rrethojnë kantinën 'Alpeta'. Vera 'Alpeta' ka bërë një rrugë të gjatë në kohë për cilësinë e saj. Vera është një përzierje merlot-kabernet, e stazhonuar në fuçi. Disa nga llojet e veres që kantina ofron janë autoktonin shqiptar, shesh i zi, rrush dimëror si dhe disa varietete të njohura ndërkombëtarisht si: kabernet, merlot dhe muskat

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: alpetawinery@gmail.com ose në +355697484361.

AIDA përfaqësohet nga prodhuesit shqiptarë



Djathra Rapsodia

Baxho "Rapsodia", e themeluar në vitin 2009, ndodhet në fshatin Kraje të Lezhës. Kjo baxho prodhon djathë dhie, djathë lope, djathë nape, djathë kaçkavall, gjalp, mazë dhe kos. Çdo produkt i kësaj baxhoje bëhet nga qumështi i fresket i fshatarëve, i cili kontrollohet nga laborantët, mbahet në kushtet e duhura dhe më pas kalon në proceset e tjera, për prodhimin e një djathi cilësor pa niseshte. Djathërat Rapsodia dhe produktet e tjera, mund t'i gjëni në dyqanin e Rapsodisë, si edhe në disa supermarkete në qytetin e Lezhës.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@rapsodia.al.

AIDA përfaqësohet nga prodhuesit shqiptarë



Produkte bulmeti "Fshatçe"

Produktet "Fshatçe" përfaqësojnë një markë të re të produkteve të bulmetit, të prodhuara në fermën prej 200 hektarësh, të ndërtuar në fshatin Libofshë të Fierit. Për prodhimin e produkteve të bulmetit, përdoren lopë dhe viçë të rracës Holstein, të cilat ushqehen në mënyrë organike, për të dhënë një qumësht 100 % natyral. Ferma "Fshatçe" përdor aparaturat më të fundit teknologjike dhe nëpërmjet kontrollit maksimal, bëhet e mundur nxjerrja e një produkti final cilësor.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@fshatce.al.



zojdh të vendit



Uji "Qafë Mali"

Uji "Qafë Mali" buron nga "Kroi i Hjes", në Qafë Mali, Puke. Uji buron nga thellesitë e mëdha të tokës, i filtruar në mënyrë natyrale nga shkëmbinjte nëntokësor në zemër të maleve dhe i mbrojtur nga ndikimet e ndotjes së mjedisit. Uji i nënshtrohet një procesi teknologjik për pastrim dhe sterilizim sipas standardeve të BE së, për të siguruar cilësinë maksimale. Përbajtja e magnezit dhe sasia e ulët e natriumit e bëjnë këtë ujë të lehtë dhe të rekomandueshëm për të gjitha moshat.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: ujeqafemali@hotmail.com.



zojdh të vendit



Kantina e pijeve "Dogjani"

Kantina e pijeve alkoolike "Dogjani", e ndërtuar në qytetin e Kukësit, ka mbi 6 vite që operon në treg. Kantina prodhon varietete të ndryshme rakië, si: raki thane, manaferra, qershie, ftoi, dardhe, dëllinje, lloje të ndryshme verërash: shesh i zi, vranac, riesling, merlot, cabernet, si edhe Xhin. Prodhimet e kantinës "Dogjani" plotësojnë standartet evropiane të sigurisë, duke ofruar një produkt cilësor dhe konkurrues edhe në tregun e huaj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: dogjanishpk@hotmail.com, ose telefon: 069 333 3717.



zojdh të vendit



Kantina e pijeve alkoolike "Ervin-L91"

Kantina e prodhimit dhe tregtimit të pijeve "Ervin-L91", i ka fillimet e veta që në vitin 1968. Kantina "Ervin-L91" në Kukës, shquhet për prodhimin e rakisë së kumbullës, rrushit manaferras, thanes, dardhes së eger, etj, duke lu përshatuar kërkeses së tregut dhe konsumatorëve. Kantina përdor teknologjinë më të fundit, ku nëpërmjet teknologjeve dhe një sërë procesesh arrihet në një produkt cilësor.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: ervin-l91@hotmail.com, ose telefon: 068 20 21 042



zojdh të vendit



"KAPPA OIL"

KAPPA OIL është themeluar në vitin 1992, në qytetin e Durrësit, si kompania e parë e prodhimit të vajrave lubrifikantë dhe aksesorëve të tjerë për automjetet. KAPPA OIL, me një staf të kualifikuar dhe aplikim të rreptë të kontrollit të cilësisë, ofron produkte cilësore duke përbushur nevojat dhe kërkesat e klientëve. Kompania është certifikuar edhe me disa standarde nga markat më të njohura Evropiane. KAPPA OIL mbulon 50% të tregut vendas dhe eksporton në mbi 20 shtete Evropiane.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kappaoil.com.al ose +355 52 264 403.



Fabrika e qumështit "VITA 2001"

Fabrika "VITA 2001" e themeluar në vitin 2000, në fshatin Nizhavec, Pogradec, ofron në treg produkte tradicionale bulmeti, nga kullotat e Malit të Thatë. "VITA 2001" përdor qumësht 100% natyral, i cili nuk përmban konservantë. Në fabrikë prodhohen produktet si: qumësht për konsum, kos, dhallë, gjalp, salcë kosi, djath i bardhë dhe kaçkavall. Produktet me logon "VITA 2001" i nënshtrohen kontrollit të cilësisë, duke sjellë në treg të konsumatorëve shqiptar produkte të sigurta.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: tpupa27@hotmail.com ose 068 264 4057.



Kantina e verës "Arlind"

Kantina e verës "Arlind" e cila ndodhet në Drashovicë, Vlorë, ruan mënyrën artizanale të prodhimit të verës dhe produkteve të tjera. Kantina "Arlind" prodhon lloje të ndryshme të "Verës Merlot" dhe "Verën Kabinet".

Gjithashtu, në kantinë prodhohen edhe lloje të ndryshme të rakisë së rushtit dhe një lloj i veçantë rakië që ruhet në fuçi prej dru lisi. Kantina "Arlind" është vlerësuar edhe me shumë çmime kombëtare, për verën e saj cilësore.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: kantinaarilind@hotmail.com ose 068 204 1978.



Produktet bulmeti "SOAL"

Fabrika e përpunimit të qumështit "SOAL" e themeluar në qytetin e Lushnjes, prodhon produkte të sigurta, duke përdorur qumësht 100% natyral. Për prodhimin e produkteve të bulmetit kompania i kushton vëmendje të lartë kontrollit të cilësisë së qumështit, i cili direkt kalon në laboratorin e fabrikës përpara se të shkojë për përpunim. Në fabrikë prodhohen produktet si: qumësht për konsum, kos, gjalp, djath i bardhë dhe kaçkavall, dhallë, si dhe salcë kosi.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: soal94@live.com ose 068 604 2664.



Produktet bulmeti "Lushjka Bi-En"

Fabrika e prodhimit të produkteve bulmetore "Lushjka Bi-En" është themeluar në vitin 1992, në fshatin Blerimaj, Kavajë. Kompania përdor qumësht 100% natyral, të fermerëve të zonës, për prodhimin e produkteve bulmetore dhe të kontrolluara brenda standardeve të cilësisë në laboratorët e fabrikës.

Nën markën "Lushjka Bi-En" prodhohen produktet: qumësht për konsum, kos, dhallë, djath i bardhë, djath kaçkavall, si dhe salcë kosi.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
në: 069 700 6050.



**Sfungjerët Eksfoliues
Luffa**

"Rinora Handmade" është biznesi që merret me rritjen e sfungjerit bimor Luffa. Ky sfungjer prodhohet për herë të parë në Shqipëri dhe kultivohet në fashatin Kuç të qytetit të Beratit. "Rinora Handmade" përveç përdorimit të sfungjerit në formën e tij natyrale, ka filluar dhe prodhimin e sapunit artizanale të integruar në sfungjerin luffa, si dhe trajtimin e sfungjerit me pambuk egjiptian për trupin. "Rinora Handmade" për shkak të cilësisë maksimale të sfungjerit, ka filluar eksportimin edhe në Gjermani.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
 në: rinorahandmade@gmail.com



"Immortelle Tiranë"

"Immortelle Tiranë" është një biznes i krijuar në vitin 2020, për shitjen e cajrave dhe vajrave esenciale. Duke parë përfitimet e shumta nga këto bimë medicinale dhe aromatike, kompania vendosi të zgjeroje gamën e produkteve edhe me prodhimin e sapuneve për mirëqenien e duarve dhe trupit, si edhe mjaltit. Immortelle Tiranë ofron tashmë një gamë të gjerë të produkteve artizanale, të një standarti të lartë.


E duam shqip dhe zgjedhim tonën
 në: info@immortelletirane.com ose
 në 068 267 2727.



**"Bees & Trees" Bio
Kozmetikë**

"Bees & Trees" është marka e parë Shqiptare e kozmetikës e regjistruar në BE, e themeluar nga farmacistja Rona Nushi, në vitin 2014. Produktet kozmetike të kompanisë janë me përberje 100% natyrale dhe të testuara dermatologjikisht. Produktet e "Bees & Trees" nuk përmbajnë aromatizues sintetik, por aroma e tyre vjen nga kombinimi i përberësve me prejardhje natyrale. Çdo produkt është si një vepër arti, i cili kalon në diza faza, duke filluar nga përberësit, përgatitja, paketimi, dizajni dhe marketing.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën
 në: info@shopbeesandtrees.com ose
 069 577 8447.



zgjidh të vendit

●●● PRODUKTE SHQIPTARE NDËR VITE

Shqipëria e para '90-ës dhe prodhimet e atyre dekadave shenjuan një etapë të caktuar të historisë së markave vendase. Asokohe, një gamë e gjerë produktesh të prodhuara në punishtet e fabrikat modeste, u shndërruan në 'brende'. Ishin prodhime origjinale shqiptare që krijuan identitet me të gjitha elementet që një markë mund të perceptohet si e tillë.

Duket sikur sot, shumë prej produkteve, sendeve, objekteve, pijeve a ushqimeve në Shqipërinë e para '90-ës ose nuk prodhohen më, ose janë thjesht pjesë e kujtesë a nostalgjisë për gjenaratën që e jetoi atë kohë. Por, po sot, duket se më të rinjtë kanë kureshtje për të zbuluar dhe për të mësuar rreth brendeve shqiptare që kanë bërë histori.

AIDA në një përpjekje për një retrospektivë modeste rreth produkteve me origjinë

shqiptare, në një rubrikë të veçantë, bëri pjesë të katalogut "Zgjidh të Vëndit" disa nga brendet që u shndërruan në simbole dhe madje i rezituan kohës.

Populli ynë ka ditur të ruaj autenticitetin dhe ka krijuar traditën e prodhimeve të cilat identifikohen si "Made in Albania". Ne jemi banorë të hershëm të vëndit tonë dhe si të tillë 'brendi shqiptar' është vulë për shumë prodhime që endën traditën e produkteve origjinale e burimore shqiptare.

AIDA për pak histori, nostalgji, për të risjellë edhe kulturën e markave autentike, sidomos të prodhimeve që datojnë para viteve '90, në katalogun e katërt të "Zgjidh të vëndit"- zgjedh "Fabrika e llampave elektrike, Vlorë", "Sapuni Venus", "Cigare Porti" dhe "Fabrika e Pëlhurave, Shkodër".



• Rrënjët janë të rëndësishme •





AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Fabrika e llampave elektrike, Vlorë

Në Vlorë, është ngritur Fabrika e llampave elektrike në vitin 1969, gjatë aksionit për elektrifikimin e fshatrave. Kjo fabrikë e industrisë elektroteknike, prodhonte llampa elektrike inkandesente dhe lumineshente me tensione dhe fuqi të ndryshme dhe zbatonte teknologji të nivelit bashkëkohor. Në vitin 1985 shtohen lloje të reja të prodhimeve dhe prodhimi i përgjithshëm industrial ishte rritur me 1.8 herë, ndërsa prodhimi i llampave me 2.6 herë, krahasuar me vitin 1976.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Fabrika e Pëllhurave, Shkodër

Një ndër fabrikat e para të industrisë tekstile në vendit, është Fabrika e Pëllhurave në Shkodër, e cila u ngrit më 1947 nga shtetëzimi i dy punishteve të themeluara në vitet '30. Në vitet e para, kjo fabrikë prodhonte vetëm beze dhe peshqirë të thjeshtë dhe shumica e punëtorëve ishin gra. Më tej, në vitet '70 rritet aftësia prodhuese me ngritjen e repartëve të reja, duke prodhuar edhe tekstile të pambukta të stampuara, tekstile me fill mëndafshi natyror e artificial, peshqirë, trikotazhe dhe të tjera. Krahas mbulimit të nevojave të vendit në atë kohë, eksportoheshin 85% e prodhimit të peshqirëve dhe 80% e shamive të stampuara.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Sapuni Venus

Punishtja e parë e sapunit në Shqipëri është ngritur më 1897 në Shkodër dhe gjithsej para vitit 1944 kishte 6 fabrika të vogla dhe 54 punishte artizanale sapuni, në Korçë, Tiranë, Durrës dhe Elbasan, me shkallë shumë të ulët mekanizimi. Në Shkodër, në vitet 1920 prodhohej sapun dhe parfume të ndryshme, ku një nga më të famshmit e kohës ishte sapuni Venus nga Tef Pogu. Ky sapun marketohej në gazetat e asaj kohe. Industria e sapunit vijoi të rritej në vend, ku më 1982 prodhimi i sapunit ishte rritur me 13 herë, krahasuar me vitin 1938.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Cigare Porti

Fabrika e Cigareve "Telat Noga", u ngrit në vitin 1945, pas shtetëzimit të fabrikës private Stamles, në Durrës. Në vitet '50 fabrika u zgjerua dhe u pajis me makineri të reja, ndërsa në vitin 1957 filloi dhe eksporti i i cigareve. Kryesisht eksportohej në vendet e Europës Lindore si Hungari, Poloni, Çekosllovakia dhe Republika Demokratike Gjermane. Rikonstruksioni i plotë i fabrikës përfundoi në vitin 1961 dhe më pas, në rritin 1966 filluan të prodhoheshin vetëm cigareve me filter. Ndër cigaret që ka prodhuar kjo fabrikë është edhe Porti, që eksportohej jashtë vendit.

Nebije Qotaj

Adresa: Shkodër
Email: nesa.zogaj@gmail.com
Telefon: 068 226 2678

Ina's Farm

Telefon: 069 700 0069

Bllaca

Adresa: Durrës
Email: Edit_25@live.com
Telefon: 067 220 9746

Kantina e Verës Librazhd

Adresa: Librazhd
Email: veralibrazhd@ymail.com
Telefon: 069 325 7155

Driza

Adresa: Patos
Email: drizaal@yahoo.it
Telefon: 069 209 9661

Deka

Adresa: Tiranë
Email: info@deka.al
Telefon: 04 509 027

AGI 11

Adresa: Berat
Email: info@agi11.com
Telefon: 069 409 3150

Baxho A & S Zall-Herr

Adresa: Tiranë
Email: shpetim.mustafai@yahoo.com
Telefon: 068 205 5657

Beba Cosmetic

Adresa: Durrës
Email: info@bebacosmetics.com
Telefon: 069 205 7207

Pularia Tirana

Adresa: Tiranë
Email: info@pulariatirana.com
Telefon: 068 600 0089

Vital

Telefon: 069 283 8333

Pali Estate

Adresa: Lushnje
Email: info@paliestate.al
Telefon: 069 409 0000

NANA – Bio Flores

Adresa: Elbasan
Email: info@bioflores.al
Telefon: 067 741 2000

Kantina Alpeta

Adresa: Berat
Email: alpetawinery@gmail.com
Telefon: 069 748 4361

Rapsodia

Adresa: Lezhë
Email: info@rapsodia.al
Telefon: 068 294 7771

Fshatçe

Adresa: Fier
Email: info@fshatce.al
Telefon: 069 404 6222

Ujë “Qafë Mali”

Adresa: Pukë
Email: ujeqafemali@hotmail.com
Telefon: 068 400 0032

Kantina Dogjani

Adresa: Kukës
Email: dogjanishpk@hotmail.com
Telefon: 069 333 3717

Kantina Ervin-L91

Adresa: Kukës
Email: ervin-l91@hotmail.com
Telefon: 068 202 1042

Kappa Oil

Adresa: Durrës
Email: info@kappaoil.com.al
Telefon: +355 52 264 403

Vita 2001

Adresa: Pogradec
Email: tpupa27@hotmail.com
Telefon: 068 264 4057

Kantina e Verës Arlind

Adresa: Vlorë
Email: kantinaarlind@hotmail.com
Telefon: 068 204 1978

Soal

Adresa: Lushnje
Email: soal94@live.com
Telefon: 068 604 2664

Lushjka Bi-En

Adresa: Kavajë
Email: lushkja@outlook.com
Telefon: 069 700 6050

Rinora Handmade

Adresa: Berat
Email: rinorahandmade@gmail.com
Telefon: 069 848 9173

Bees & Trees

Adresa: Tiranë
Email: info@shopbeesandtrees.com
Telefon: 069 522 8447


Immortelle Tiranë

Adresa: Tiranë
Email: info@immortelletirane.com
Telefon: 068 267 2727



AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)

 Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

 +355 (0) 42251001

 www.aida.gov.al

 info@aida.gov.al



• Rrënjët janë të rëndësishme •

© Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve



AIDA

Adresa Rruga "Skerdilajd Llagami",
Nd.1, H.6, Tiranë
Tel: +355 (0) 42251001
Web: www.aida.gov.al
e-mail: info@aida.gov.al